

BURSA SHQIPTARE E ENERGJISË ELEKTRIKE - ALPEX SH.A

VENDIM TEKNIK Nr. 3-T

“Procedurat e tregimit emergjent në Tregjet e ALPEX”

Duke marrë në konsideratë dispozitat e seksionit F.3 dhe paragrafit B.4.3 të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike – Kushtet e Përgjithshme dhe paragrafët A.2.4.5 dhe A.2.4.6 të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurat e Tregimit të ALPEX sh.a, të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike sh.a (në vijim referuar si “ALPEX”), siç janë në fuqi:

ALPEX SH.A miratoi:

1. Vendimi Teknik - Procedurat e Tregimit Emergjent në Tregjet e ALPEX.
2. Ky Vendim Teknik Nr. 3-T i paraqitet për njoftim Entit Rregullator të Energjisë - ERE dhe Zyrës së Rregullatorit për Energji - ZRrE.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ADMINISTRATORI I ALPEX SH.A

Sokol Dishnica

Neni 1

Objekti - Fushëveprimi -Përkufizimet

- (a) Objektivi i këtij vendimi është të përcaktojë mekanizmat dhe procedurat alternative të tregtimit në rast të keq funksionimit të Sistemit të Tregtimit të Energjisë në Çast (ETSS) ose emergjencave të tjera, me qëllim ruajtjen e funksionimit të duhur të Tregjeve të ALPEX-it dhe mbrojtjen e interesave të Anëtarëve të Bursës.
- (b) Përkufizimet e këtij Vendimi Teknik kanë të njëjtin kuptim si ato të parashikuara në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike - Përkufizimet ose Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike – Kushtet e Përgjithshme dhe Procedurat dhe në legjislacionin përkatës lidhur me tregjet e energjisë elektrike.

Neni 2

Veprimet që ndërmerren në rastet përjashtimore nga tregtimi i zakonshëm, Klerimi dhe Shlyerja ose emergjenca të tjera.

- (a) Në rast të keq funksionimeve të rrjetit, keq funksionimeve të sistemit ETSS, keq funksionimeve të komunikimit të Sistemit të Tregtimit të Energjisë në Çast (ETSS) me Sistemin e Klerimit të Tregut të Energjisë (EMCS), apo keq funksionimeve në sistemet periferike, ALPEX do të garantojë se:
 - (i) është zbuluar keq funksionimi dhe sistemi i menaxhimit për këtë problem do të aktivizohet
 - (ii) janë ndërmarrë veprime korrigjuese, dhe
 - (iii) veprimet për zgjidhjen e keq funksionimit regjistrohen, duke informuar Anëtarët e Bursës me çdo mjet të përshtatshëm për problemin.
- (b) Në rast të problemeve të shfaqura në paragrafin e mësipërm (a), do të ndërmerren masat e përshkruara në nënseksionin F.3.1.2 të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike–Kushtet e Përgjithshme.

Neni 3

Procedura për mbështetjen e Tregtimit të Anëtarëve të Bursës

- (a) Në rast të keq funksionimeve teknike të sistemeve të Anëtarëve të Bursës ose emergjencave të tjera, ALPEX-i u mundëson Anëtarëve të Bursës akses në ETSS nëpërmjet shërbimit “Tregtimi në Emër të Dikujt Tjetër” të ALPEX siç përshkruhet në seksionin G.3 të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike –Procedurat e Tregtimit.
- (b) Në këtë rast, Agjentët Tregtar të Certifikuar, të cilët tashmë janë të regjistruar në bazën e të dhënave të Anëtarëve të Bursës, mund të aplikojnë nëpërmjet një linje telefonike të regjistruar ose nëpërmjet Mjetit Elektronik të Emëruar (i cili do të sigurohet nga ALPEX-i) për ndihmën e ALPEX-it, për dorëzimin e një Urdhërporosie të re në ETSS, për modifikimin ose për anulimin e një Urdhërporosie

të dorëzuar, duke plotësuar të gjitha fushat e detyrueshme të Urdhërporosisë me ndihmën e ALPEX-it dhe në çdo rast 20 (njëzetë) minuta përpara Kohës përkatëse të Mbylljes së Portës. ALPEX-i do të kërkojë gjithashtu konfirmimin e Urdhërporosisë, nëpërmjet një formulari të përshtatshëm për regjistrimin e fushave të detyrueshme të Llojeve të Urdhërporosive, të ofruara nga ALPEX-i. Anëtari i Bursës nuk mund të pretendojë se Urdhërporositë janë dorëzuar në ETSS nëse nuk kanë marrë një konfirmim me shkrim nga ALPEX-i. Për më tepër, ALPEX nuk do të garantojë disponueshmërinë e numrit të mjaftueshëm të linjave telefonike. Shërbimi “Tregtimi në Emër të Dikujt Tjetër” mund të përdoret vetëm për D-1 (orët e punës), në kuadër të Ditës së Livrimit.

- (c) ALPEX nuk mban asnjë përgjegjësi për dorëzimin me vonesë të Urdhërporosive gjatë përdorimit të shërbimit “Tregtimi në Emër të Dikujt Tjetër”. Nëse paraqitet një numër i madh kërkesash, ALPEX-i do të dorëzojë Urdhërporositë duke u bazuar në parimin e përparësisë kohore, përveç rasteve kur ka arsye për ruajtjen e funksionimit të mirë të tregut ose parandalimin e rreziqeve për Klerimin e Transaksioneve, që justifikojnë shmangien nga parimi i sipërpërmendur. Në çdo rast, plotësimi i kërkesës është parakusht për ofrimin e shërbimit.

Neni 4

Detajet teknike të regjistrimit të bisedave telefonike apo ruajtjes së shkëmbimit të të dhënave për shërbimin “Tregtimi në Emër të Dikujt Tjetër”.

- (a) ALPEX do të regjistrojë bisedat telefonike apo do të ruajë shkëmbimet e të dhënave që lidhen me dorëzimin e Urdhërporosive të reja në ETSS, modifikimin ose anulimin e një Urdhërporosie të dorëzuar, duke marrë të gjitha masat e nevojshme të sigurisë.
- (b) ALPEX do të verifikojë identitetin e telefonuesit përpara se të kryejë shërbimin “Tregtimi në Emër të Dikujt Tjetër”.
- (c) Numri/at e telefonit për komunikimet me ALPEX-in do të postohen në faqen zyrtare të internetit të ALPEX www.alpex.al.
- (d) Nuk lejohet kryerja e shërbimit “Tregtimi në Emër të Dikujt Tjetër” nga numra të tjerë të telefonit të Agjentëve Tregtar të Certifikuar, përveç atyre të dhëna në Marrëveshjen e Anëtarësimit në Bursë.

Neni 5

Hyrja në fuqi

Ky Vendim Teknik hyn në fuqi më datë 07.09.2023.

Ky Vendim Teknik do të publikohet në faqen zyrtare të internetit të ALPEX www.alpex.al